

ABSTRAKT

Në këtë punim do të diskutohet për të drejtën pasurore të autorit, si e drejtë civile e ku do të përfshihet rregullimi dhe përmbajtja e saj, format e shfrytëzimit të saj, kushtet e mbrojtjes që parashihen në sistemin juridik të Kosovës. E drejta e autorit, si një nga institutet kryesore të së drejtës së pronësisë intelektuale, në veçanti i rregullon aspektet e përcaktimit të kuptimit të veprës së autorit, njohjës dhe garantimit të të drejtave morale dhe pasurore të autorit, si dhe mundësisë së eksplotimit ekonomik të veprës së autorit.

Synimet e përgjithshme të forcimit të legjislacionit në lidhje me pronësinë intelektuale janë mbrojtja e të drejtës së autorit. Në ditët e sotme mundësitë për të përdorur dhe për të përfituar nga të drejtat e autorit janë të shumta, por duhet të kihet parasysh respektimi i këtyre të drejtave dhe pajisja me lejeautorizim nga titullarët e të drejtave. E drejta e autorit e mbron krijuesin nga çdo përdorim i paautorizuar i veprës së tij dhe i siguron atij një shpërblim për çfarëdo përdorimi të veprës së tij, sepse e drejta e autorit paraqet një institut juridik të veçantë dhe si e tillë është një pushtet me autorizime për titullarin e të drejtës së autorit.

Tutje, në këtë punim do të trajtohet edhe mardhënia e të drejtave të autorit me të drejtën e pronësisë.

Do të shohim si mbrohen të drejtat e autorit në mënyrë sa më efçiente dhe sa qartë shprehet ligji i Kosovës në lidhje me to. Së fundmi do të arrijmë të kuptojmë se cila është mënyra më e mirë e funksionimit të mekanizmave të mbrojtjes duke marrë parasysh mjetet që aktualisht autorët kanë në dispozicion.

Fjalët kyçe: autor, e drejtë pasurore e autorit, mbrojtje juridike.